



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:007318

Datë: 25.07.2018

Numri i dokumentit: 00089535

PKR.nr.22/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët Kymete Kicaj e Nazim Vllaqo - anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Birsen Kume, duke vendosur në lëndën penale, kundër të akuzuarve F. M. e R. K., që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP- së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit PP/I nr.191/2017 të datës 13.03.2018, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre Av. A. P. dhe av. A. Th., me datë 22.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F. M., nga i ati F. dhe e ëma S. e lindur M., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Sindelfingen - Gjermani, tani me banim në Prizren në Rrugën ... (Z. P.) llamella ... banesa nr.. i papunë, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore , i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.R. K., nga i ati I. dhe e ëma H., e lindur K., i lindur me *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton në Rrugën ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse pa autorizim kanë poseduar me qëllim shitje apo shpërndarje substanca apo preparate të shpallura me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që me datë 28.10.2017, në park afër QKMF në Prizren, kanë mbushur qese të vogla me narkotik të llojit “marihuanë” e pastaj me datë 03.11.2017. në bodrumin e adaptuar për fjetje të banesës nr.. lllamella .. në rrugën ... në Prizren, pronë e prindit të të akuzuarit F., kanë mbajtur të fshehur dy qese najloni të mbushura me narkotik të llojit “marihuanë” njëra në peshë prej 52.51 gram, kurse tjetra në peshë prej 13.85 gr. Dhe një cigare në peshë prej 0.30 gr, narkotik i llojit “marihuanë” në peshë të përgjithshme prej 66.36 + ose-0.0001 dhe 18 qese të vogla të najlonit ku bëhet vendosja me qëllim shitje ose shpërndarje e narkotikut të llojit të lartcekur.

Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP- së.

Gjykata në kuptim të dispozitave së lartshënuara dhe neneve: 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 73 dhe nenit 273 paragr.1 lidhur me nenin 31 të KP-së të akuzuarit i :

G J Y K O N

1.Të akuzuarin F. M.

-Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimin me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do t'i caktohet një ditë burgim dhe,

-Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 03.11.2017 deri më datën 22.06.2018.

2.Të akuzuarin R. K.

-Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimin me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do t'i caktohet një ditë burgim dhe,

-Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 03.11.2017 deri më datën 22.06.2018.

Në pajtim me nenin 273 paragrafi 5 të akuzuarve ju konfiskohet sasia e narkotikut në peshë prej 66.36 gram.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguajnë paushallin në lartësi secili prej nga 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe secili prej nga 50 (pesëdhjetë)

euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar Aktakuzën PP/I nr.191/2017 të datës 13.03.2018 kundër të akuzuarve F. M. e R. K., që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP- së. Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat që u administruan në këtë gjykim me pamëdyshje është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit F. M. dhe R. K. kanë bashkëkryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Nga provat materiale konkretisht procesverbali mbi bastisjen e banesës të të akuzuarit Fitim Musliu me pamëdyshje u vërtetua se përveç sasisë së narkotikut që është gjetur në bodrumin e banesës së tij janë gjetur edhe 18 qese të vogla të najlonit, të destinuara për paketim të substancës narkotike e pastaj për qëllim shitje ose shpërndarje. Nga raporti i ekspertimit të AKF u vërtetua se kemi të bëjmë me narkotikun të llojit marihuanë. Nga deklaratat e dëshmitares S. M., e cila deklaratë nuk kontestohet as nga të akuzuarit vërtetohet fakti se sasia e narkotikut vërtet është gjetur në bodrumin e banesës së saj së bashku me 18 qese të najlonit. Nga deklaratat e të akuzuarve F. M. e R. K. që kanë dhënë edhe në gjykatë në tërësi pohohet fakti se në marrëveshje reciproke kanë shkuar në lokalin "jumbo" ku kanë blerë një sasi bukur të madhe të qeseve të najlonit e pastaj ato i kanë marr, kanë ardh në parkun afër QKMF në Prizren ku në ato qese kanë vendosur narkotikun të llojit marihuanë, e pastaj pjesën e mbetur të narkotikut së bashku me qeset e zbrazura i kanë marr dhe i kanë fshehur në bodrumin e banesës së të akuzuarit F. M.. Prandaj, mbrojtja e të akuzuarit F. M. se sasia e narkotikut që është gjetur në banesën e tij nuk është prone e tij por e të akuzuarit R. K., konsideroj se për gjykatën nuk duhet të jetë me relevancë për arsye se të dy kanë qenë në dijeni dhe të dy kanë vepruar në atë mënyrë që sasinë e narkotikut e kanë paketuar nëpër qese najloni me qëllim qoftë e shitjes apo të shpërndarjes. Po ashtu nga deklaratat e të akuzuarve nuk mohohet fakti se i akuzuari R. përveç këtij fakti ka pas raste që edhe më herët personave tjerë u ka shpërndarë narkotikë, prandaj konsideroj se nga këto prova që janë administruar gjithanshëm në këtë gjykatë janë formuar të gjitha elementet qenësore të veprës penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit, prandaj i propozoj gjykatës që ti shpall fajtorë dhe ti gjykojë sipas ligjit. Me rastin e caktimit të dënimit gjykatës i propozoj që prej rrethanave lehtësuese të ketë parasysh për të akuzuarin F. M. se i njëjti është i moshës së re, kurse sa i përket të akuzuarit R. po ashtu të merr parasysh faktin se i njëjti një gjeneratë është i moshës së re, kurse prej rrethanave rënduese të ketë parasysh peshën e veprës penale që kanë kryer të akuzuari gjithashtu ka propozuar që të akuzuarve tu shqiptohet dënimi plotësues konfiskimit të narkotikut dhe qeseve të sekuestruara.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. M. Av. A. P., gjatë shqyrtimit kryesorë në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda me datë 13.03.2018 ka ngrit aktakuzë kundër F. M. për veprën penale, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave tjera psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, me përshkrimin e gjendjes faktike

si në dispozitiv të aktakuzës duke shtuar se në fazën e konfirmimit të aktakuzës e ka kundërshtuar këtë aktakuzë me pretendimet se cilësimi juridik i kësaj vepre penale i kalon kufijtë e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, duke pasur parasysh faktin se i akuzuari është i moshës madhor i ri, dhe se është evidente që nga mendjelehtësia dhe varësia ndaj substancave narkotike, ai ka pranuar që të strehojë te bashkakuzuarin në banesën e tij. I akuzuari nuk e konteston faktin se në ditën e bastisjes nga ana e policisë në banesën që është pronë e nënës së tij, është hasur substancë e dyshimtë e cila nga AKF është vërtetuar se është e llojit “Marihuanë”, por përtej kësaj fakti se organet policore i ka njoftuar nëna e tij dhe se i bashkakuzuari R. K. e ka pranuar se kjo substancë ka qenë e tij, kjo e zvogëlon përgjegjësinë përkitazi me të. Duke u bazuar në nenin 36 par.1,2 dhe 3 të KPP-së, ku ligji parasheh kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim paragr.1 i nenit 36 „bashkëkryerësi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet... par. 3 i nenit 36 “rrethanat personale, përfshirë cilësitë të cilat mund të rezultojnë nga përgjegjësia penale lirimi nga dënimi, ekzistimin e formave të rënda apo të lehta të veprës penale ose që ndikojnë në përcaktimin e dënimit, mund të merren parasysh vetëm ndaj personit për të cilin vlejnjë.

Nga kjo që u tha më lartë është evidente se përgjegjësia e të akuzuarit F. M. në këtë rast penal është e vogël, pasi që i njëjti nga pakujdesia dhe nevoja për këto substanca e ka sjell vetën në cilësinë e bashkëkryerësit. Për me tepër fakti që rastin e ka njoftuar nëna e tij, kjo do duhej nga gjykata që të merrej si rrethanë lehtësuese, si dhe veprimet e të mbrojturit tim sa i përket cilësimit juridik të veprës penale të rikualifikohen.

Gjithashtu duke pas parasysh faktin se i mbrojturi im është i gjendjes së rëndë ekonomike, me nënën e tij të sëmurë me diabet të shkallës së lartë dhe përkushtimin e saj që djalin e saj të kthejë në rrugë të mbarë, ka propozuar që gjykata të merr në konsideratë masën e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga, neni 4 par.2 nënpar 2.3 të KP-së, si dhe nenit 91 par.1 nënpar. 1.2 (gjkata konstaton se faktori kryesor që e ka motivuar kryerjen e veprës penale ishte varësia e kryesit nga alkooli apo droga) pasi që kjo është kërkesë edhe e nënës së të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. K. av. A. Th. gjatë shqyrtimit kryesorë në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, R. K. akuzohet se pa autorizim ka poseduar me qëllim shitjeje apo shpërndarjeje substanca apo preparate të shpallura me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjatë administrimit të provave me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari R. K. ka kryer veprën penale. Është fakt i pakontestueshëm se në bodrumin ku kanë qëndruar të bashkakuzuarit është gjetur sasia e substancave narkotike, e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, mirëpo pretendimi i prokurorisë se këto substanca narkotike janë poseduar me qëllim shpërndarjeje dhe shitjeje nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme. Dëshmitarja e vetme në këtë proces gjyqësor S. M., nëna e të bashkakuzuarit, e cila edhe e ka lajmëruar policinë, deklaroi si në prokurori edhe në seancën kryesore në gjykatë se ajo nuk e ka parë të mbrojturin tim R. K., duke shitur apo shpërndarë narkotikë. Po ashtu edhe i bashkakuzuari deklaroi se ata vetëm kanë pirë së bashku “marihuanë” por jo edhe t’i kenë shitur apo shpërndarë diku tjetër substanca narkotike. Prokuroria me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të provojë se i mbrojturi im është shitës i narkotikëve, me përjashtim të faktit se është përdorues i marihuanës gjë të cilën edhe ai vet e pranon.

Tek të akuzuarit gjithashtu nuk është gjetur ndonjë peshore, e cila do të përdorej për të peshuar narkotikët, në këtë rast marihuanën, e që do të krijoheshin elementet qenësore të

veprës penale nga neni 273 i KP-së. Nga këto prova nuk është vërtetuar dashja si element subjektiv i veprës penale për shitjen e narkotikëve. Përkundrazi, nga provat janë krijuar të gjitha elementet e veprës penale nga neni 275 i KP-së.

Nga të lartcekurat dhe provat e administruara në këtë çështje penale, edhe gjendja faktike e vërtetuar pas administrimit të provave, mund të konstatohet se: “shitja si veprim me të cilin kryhet kjo vepër penale duhet kuptuar në pajtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet Detyrimore, ashtu që shitja do të konsiderohet e kryer me vete faktin e arritjes së marrëveshjes në mes shitësit dhe blerësit për çmimin dhe mallin, ashtu që për ekzistimin e veprës penale nuk është e nevojshme që droga t’i dorëzohet blerësit, mjafton që blerësi të dijë për llojin dhe cilësinë e drogës për të cilën arrihet marrëveshje”. E Prokuroria e shtetit nuk ia ka dalë që të gjejë qoftë edhe një blerës të vetëm, me çka do të vërtetonte fajësinë e të mbrojturit tim për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pra, të gjitha faktet shkojnë në vërtetimin e gjendjes faktike, se i mbrojturi im Ramë Kasolli lëndën narkotike të gjetur në posedim tek ai e ka pasur vetëm për përdorim personal e jo edhe për shitje, andaj janë krijuar elementet e veprës penale nga neni 275 i KP-së. Në këto rrethana ka propozuar që në kuptim të nenit 364 par.1 nënparagrafi 1.3 të KPP-së, ndaj të akuzuarit R. K. të merr aktgjykim lirues në mungesë të provave për të vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor i ka nxjerrë të gjitha provat e domosdoshme dhe pas vlerësimit të secilës prove veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi, ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit R. K. e F. M. pa autorizim kanë poseduar me qëllim shitje apo shpërndarje substanca apo preparate të shpallura me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që me datë 28.10.2017, në park afër QKMF në Prizren, kanë mbushur qese të vogla me narkotik të llojit “marihuanë” e pastaj me datë 03.11.2017. në bodrumin e adaptuar për fjetje të banesës nr.. llamella ... në rrugën ... në Prizren, pronë e prindit të të akuzuarit F., kanë mbajtur të fshehur dy qese najloni të mbushura me narkotik të llojit “marihuanë” njëra në peshë prej 52.51 gram, kurse tjetra në peshë prej 13.85 gr. Dhe një cigare në peshë prej 0.30 gr, narkotik i llojit “marihuanë” në peshë të përgjithshme prej 66.36 + ose-0.0001 dhe 18 qese të vogla të najlonit ku bëhet vendosja me qëllim shitje ose shpërndarje e narkotikut të llojit të lartcekur.

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë çështje penale, ka dëgjuar dëshmitaren S. M. ka bërë leximin e procesverbalit mbi bastisjen e banesës dhe personave, ka bërë leximin e raportit të ekzaminimit të AKF në Prishtinë me nr. AKF/2017-3737/2017-3357 i datës 06.03.2018.

Dëshmitarja S. M. gjatë shqyrtimit gjyqësor sikurse para prokurorit të shtetit ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i biri i saj F. me sa i kujtohej e përdor narkotikun që nga moshën 12-13 vjeçare, i njëjti ka vjedhur gjësende nga shtëpia, ka dalë dhe i ka shitur këto gjësende për të siguruar drogë, dhe për këto vepra i njëjti ka vuajtur masën edukative disiplinore, mirëpo edhe përkundër kësaj prap ka vazhduar me përdorimin e narkotikut dhe atë duke e siguruar narkotikun përmes shokëve nga këtu i akuzuari R. K. ashtu që me shoqërinë e tij në bodrumin e banesës së tyre ku edhe i akuzuari R. K. kishte qëndruar 3 javë kanë përdorur alkool dhe drogë. Në bodrum kishte vërejtur qese të vogla me drogë, kishte vërejtur edhe qese të mëdha, kishte vërejtur edhe pas derës së bodrumit por gjithashtu ka parë edhe në bashqë, për

këtë arsye edhe kishte njoftuar edhe policinë, pasi që e njëjta ishte e vetme e gjithashtu e kishte njoftuar policinë që ta mbronte djalin e saj që me ndihmën e policisë ta largonte të njëjtin nga droga. Droga të cilën e kishte vërejtur në bodrum ishte e grirë si duhani ndërsa disa të tjera kanë qenë si kokrra, kanë pas ngjyrë të mbyllët si duhani dhe kanë qenë të vendosura në qese të vogla, ndërsa në fund të deklaruar se të akuzuarin R. K. nuk e kishte pa duke shitur drogë.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitares S. M. gjykata dëshmisë së saj në tërësi ia falë besimin nga kjo dëshmi u vërtetua se në bodrumin e banesës së saj ku jetonte kishte pa shumë qese të vogla me lëndë narkotike të vendosura në to e që në këtë bodrum qëndronte i akuzuari F. M. e gjithashtu për tri javë aty kishte qëndruar edhe i akuzuari R. K..

Nga raporti i ekspertimit të AKF në Prishtinë me nr. AKF/2017-3737/2017-3357 i datës 06.03.2018 është vërtetuar se sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmime e ekzaminuara 1 dhe 3 përmbajnë kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme 66.36 gram ndërsa dëshmia 2 përmban kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) dhe nikotinë pesha neto e përgjithshme 0,30 gram.

Nga procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave është vërtetuar se gjatë bastisjes janë konfiskuar një qese e zezë me bari të tharrë e dyshuar për narkotikë “marihuanë” pesha 57, 5 gram, 18 qese najlonit të vogla të zbratura, cigare me peshë 0,6 gram, një palë patika “Adidas” ngjyrë të zezë dhe një qese me bari të dyshimtë për narkotikë pesha 19,4 gram.

I akuzuari F. M. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se unë ka qenë i varur nga droga dhe pasi që nuk ka pasur të holla të blejë i kishte konvencuar që ai t’i sillte drogë në banesë e për këtë atij i’ka siguruar vendin që ai të flejë në bodrumin e banesës bashkë me mua. R. K. e ka pa duke përdor drogë me disa persona të moshës së tij, duke shtuar se është e vërtetë se ai ka shpërnda edhe drogë pa pagesë dhe se kanë blerë një pako 80 qese të vogla najloni, ku i kanë mbushur me narkotikë në park afër QKMF. Një sasi të drogës policia e ka gjetur në xhepin e jaknës së të akuzuarit R., një sasi e ka gjetur afër qarapave në ormanin e tij, një sasi tjetër të drogës që e kishte marr fshehtas nga R. K., dhe ka qenë në dijeni për këto dy sasi që janë gjetur në banesën e tij, gjithashtu edhe për 18 qeset e zbratura që janë gjetur nga policia në bodrumin e tij, ka deklaruar se këto qese kanë qenë të destinuara për të vendosur narkotik në to, arsyeja pse i kanë siguruar këto qese ka qenë se zakonisht R. ka pas sasi të caktuar të drogës e që shpesh herë këtë drogë e ka fshehur në një pishë afër parkut në QKMF, kështu që kur ka pas nevojë nga ajo sasi e madhe të marr sasi të vogël, për këtë qëllim i kanë futur në qese të vogla, në mënyrë që ta përdorë vet, ia kishte dhënë këtij narkotikun edhe këtij, por i ka dhënë edhe personave tjerë që ta përdorin, ndërsa nuk e kishte parë që R. të kishte shitur drogë dikujt.

Duke e analizuar mbrojtjen e të akuzuarit F. M. gjykata konstatoi se i njëjti edhe përkundër faktit se nuk e ka pranuar fajësinë ai në mbrojtjen e tij në tërësi i ka pranuar veprimet kryesë. I akuzuari F. në mbrojtjen e tij është munduar ta paraqes në atë drejtim se është vetëm konsumues i narkotikut e jo edhe shpërndarës i saj me arsyetimin se i njëjti edhe më herët ka qenë përdorues i drogës ndërsa nga ana tjetër i njëjti në tërësi e pranon se së bashku me të akuzuarin R. K. i kanë blerë 80 qese të vogla najloni e të cilat vet i akuzuari e pranon se këto qese najloni i kanë mbushur me narkotik e që sipas gjykatës në tërësi është vërtetuar se këto qese janë mbushur për shpërndarje.

I akuzuari R. K. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kishte blerë drogë për të pirë dhe se i kishte blerë sepse atëherë kishte para, e për mos me mbet pa drogë kishte blerë menjëherë 100 gramë, ka shtuar se F. M. nuk i kishte shitur ndonjëherë drogë dhe në banesën e tij kishte qëndruar 4-5 ditë, drogë i kishte dhënë për të pirë bashkë dhe sa herë që ishin takuar kishin pirë drogë bashkë. Po ashtu pohon se i ka dhënë drogë edhe shokëve tjerë me të cilët edhe kishin pirë drogë bashkë, kjo ka ndodhur në Minimax. Së bashku me F. M. kanë blerë qese të vogla në “Jumbo” që të mos mbajnë me vete gjithmonë sasi të madhe, por kur t’iu duhej droga, ta kishin me veti nga një qese të vogël të mbushur me të. Qeset i kishin mbushur në parkun e QKMF në Prizren por pa qëllim për të shitur ose për t’i shpërnda. Një sasi të narkotikut e kishin dërguar në bodrumin e Fitimit. Pranon se substanca ka qenë e tija dhe se e ka blerë vet. Ndjen keqardhje që me veprimet e tija ka inkriminuar një madhor të ri i cili nga mosha është një dekadë më i ri. Ashtu si ka deklaruar edhe në prokurori narkotiku i’u është gjetur në banesë, në trup, në gjepa, diçka tjetër nuk ka gjetur policia. Drogat nëpër qese i kanë futur pa i’u matur sasinë sepse nuk kishin peshore për të matur.

Sa i përket mbrojtjes së dhënë nga i akuzuari R. K. gjykata konstatoi se i njëjti në tërësi i ka pranuar veprimet kryesore edhe pse është deklaruar se nuk e pranon fajësinë. I njëjti në veprën e vet e pranon se kishte blerë narkotikun, e pranon se i kishte dhënë drogë edhe të akuzuarit F. M., e pranon se i kishte dhënë drogë edhe shokëve të tjerë me të cilët edhe ka konsumuar narkotikun, i njëjti gjithashtu e pranon se kishte blerë në Jumbo qese të vogla që të vendoste drogën që ta kishte me vete në sasi të vogla, e pranon se këto qese të vogla i kishte mbushur në parkun e QKMF në Prizren, edhe pse deklaron se jo për ta shitur dhe shpërndarë e që për gjykatën kjo pjesë e mbrojtjes së tij ku i njëjti nuk e pranon se ka shpërndarë apo shitur është e dhënë në tërësi me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe mbrojtja e tij është kundërthënëse në vetvete.

Nga të gjitha të lartpërmendurat, provave të administruara, dëgjimi i dëshmitarëve, si dhe pjesërisht edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit gjykata konstatoi se në rastin konkret nuk është kontestuese dhe në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit F. M. dhe R. K. ishin shokë në mes vete. I akuzuari R. K. një kohë të caktuar kishte qëndruar në bodrumin e adoptuar për fjetje pronë kjo e të akuzuarit F. M. i cili e kishte lejuar që i njëjti të qëndronte aty. R. K. kishte siguruar sasinë e narkotikut për çka që të dy të akuzuarit kishin shkuar në dyqanin “Jumbo” në Prizren kishin blerë një pako prej 80 qesesh të vogla najloni të cilat i marrin dhe shkojnë në parkun afër QKMF Prizren ku në këto qese vendosin narkotikun e të cilin narkotik e shpërndanin personave të ndryshëm të cilët konsumonin narkotik. Në bodrumin e banesës pronë e të akuzuarit F. M. ku qëndronte i akuzuari R. K. e bashkë me të edhe vetë i akuzuari F. M. mbanin narkotikun e që gjatë bastisjes ishin gjetur qese najloni të mbushura me narkotik të llojit marihuanë njëra në peshë prej 52.51g, tjetra në peshë prej 13,85g gjithashtu ishin gjetur një cigare në peshë prej 0.30 gr narkotik të llojit marihuanë në peshë të përgjithshme prej 66.36 gr gjithashtu janë gjetur 18 qese të vogla najloni ku bëhet vendosja e narkotikut me qëllim të shpërndarjes.

Se narkotikun e kanë pas në posedim të dy të akuzuarit e pohojnë vet të njëjtit në mbrojtjen e tyre. Të akuzuarit janë mbrojtur se narkotikun e kanë mbajtur në posedim vetëm për përdorimin personal, mirëpo gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar se që të dy të akuzuarit narkotikun përveç se për përdorim personal e kanë poseduar edhe për shpërndarje, pra në rastin konkret bëhet fjalë për posedimin e narkotikut me qëllim të shpërndarjes, fakt ky që është vërtetuar edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit F. M. i cili deklaron se i akuzuari R. K. ju ka dhënë narkotik edhe personave tjerë por që nuk jua ka shitur, e që për gjykatën kjo nënkupton se i njëjti ka bërë shpërndarje të paautorizuar të narkotikut, kjo gjithashtu është

vërtetuar edhe nga fakti se që të dy të akuzuarit kishin shkuar dhe kishin blerë në lokalitetin “Jumbo” 80 qese të vogla najloni në të cilat qese kishin vendosur narkotik e krejt këto sipas gjykatës me qëllim të shpërndarjes së narkotikut.

Gjykata nga të cekurat më lartë, konstatoi se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për rikualifikim të veprës penale ashtu siç kanë kërkuar mbrojtësit të të akuzuarve pasi që në mënyrë të padyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve F. M. e R. K., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, në bashkëkryerje, të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273, par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, prandaj edhe të njëjtët i shpalli fajtor dhe u shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në neni 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve, se të njëjtët janë të gjendjes së dobët ekonomike, që të dy të akuzuarit janë të moshës relativisht të re, në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt të njëjtët edhe përkundër faktit se janë deklaruar të pafajshëm ata në të vërtetë i kanë pranuar veprimet kryese, ndërsa gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë rast, kështu prandaj në këto rrethana gjykata konsideroi se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i tij nga neni 41 i KPK-së dhe ky dënim i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedojnë të të akuzuarit, dhe se dënimin i tillë do të parandalojë të njëjtët nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, e gjithashtu do të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe se një dënim i tillë shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451, par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
Pkr.nr.22/18 me datë 22.06.2018

Procesmbajtësja
Birsen Kume

Kryetari i Trupit Gjykses
Skender Çoçaj

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, ndaj këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtët, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.